

VENDIM
Nr.18, datë 1.11.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE, LIGJIN NR.7665, DATË 21.1.1993 “PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE QË KANË PËRPARËSI TURIZMIN”, SHFUQIZUAR ME LIGJIN NR.9734, DATË 14. 5. 2007 “PËR TURIZMIN”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z.Genc Ruli	- kryetar
Znj.Mimoza Dhëmbi	- anëtare
Z.Viktor Gumi	- anëtar
Z.Ledi Bianku	- anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 1.11.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin””, të ndryshuar me ligjin nr.9734, datë 14.05.2007 “Për turizmin”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr. AI/004/2005.

BAZA LIGJORE: Si bazë për dhënien e ndihmës ka qenë ligji nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, i shfuqizuar me ligjin nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”.

OBJEKTIVI/AT: Skema ka si qëllim nxitjen e investimeve në sektorin e turizmit, nëpërmjet përjashtimeve të ndryshme nga taksat, si dhe dhënies së garancive nga ana e shtetit për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në këtë sektor.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema fillestare përfshinte personat e stimuluar, të cilët sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, kishin të drejtën të përjashtoheshin nga taksat e detyrimet doganore, si dhe të kundërbalanconin humbjet e pësuar gjatë 5 viteve të para të zhvillimit të veprimtarisë.

2. Lejet e dhëna në bazë të atij ligji, janë aplikuar jo vetëm për zhvillimet e lidhura me turizmin, por edhe për forma të tjera zhvillimi brenda zonës, që kanë prekur qëllimin dhe theksin turistik të tyre.

3. Megjithëse në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” jepej e drejta e lidhjes së marrëveshjes për qiranë e tokës, në të nuk përcaktoheshin strukturat e menaxhimit dhe kontrollit, si dhe nuk krijoheshin lidhje me kriteret dhe standardet e pritshme të zhvillimit.

4. Ndryshe nga ligji i vjetër, që përmbante në vetvete skema të drejtpërdrejta të ndihmës shtetërore për sektorin e turizmit, ligji i ri nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, parashikon në formë të përgjithshme mekanizmat e mbështetjes financiare.

5. Ligji i ri parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për procedurat që duhen ndjekur për dhënien apo monitorimin e skemave mbështetëse për këtë sektor.

6. Ai ngarkon Agjencinë Kombëtare të Turizmit për hartimin e programeve financiare për mbështetjen e turizmit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave për dhënien dhe menaxhimin e asistencës financiare për ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e turizmit.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 13, pika 3, nenit 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe nenit 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Të konsiderojë në përputhje me dispozitat e legjislacionit të ndihmës shtetërore në fuqi ligjin nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” që ka shfuqizuar skemën ekzistuese të ndihmës shtetërore, ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.

2. Të gjitha organet shtetërore që, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, ndihmojnë zhvillimin e turizmit duke propozuar politika të lehtësive fiskale për bizneset turistike, për individët dhe subjektet juridike, janë të detyruara që, për çdo plan skeme ndihme apo ndihme të re individuale, të ndjekin të gjitha procedurat e parashikuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore.

3. Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe organet e tjera shtetërore, brenda datës 31 mars të çdo viti, të raportojnë pranë DNSH-së për të dhënat e zbatimit të skemave të ndihmës dhe çdo ndihme individuale gjatë vitit paraardhës financiar në kuadër të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”.

4. Agjencia Kombëtare e Turizmit të ruajë të dhënat për skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale të përfituara në bazë të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” deri pas 10 vjetësh nga data e dhënies së fundit të asistencës financiare në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli